

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE

për klasën V

Shkup, 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	V (e pestë)
Tema/fusha programore	1. Gjuhë dhe komunikim 2. Letërsi dhe krijimtari 3. Njohuri mediatike dhe kulturë e medias
Numri i orëve	5 orë në javë / 180 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • tablet, kompjuter; • tabelë e mençur; • lapustila (markera) shumëngjyrësh, lapsa, letra; • fletëza mësimore, plakate, kartela me fjalë, shirita me fjali, afishe, ilustrime me figura që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë; • libra (me tregime, tregime të shkurtra, romane për fëmijë, përralla, përrallëza, vjersha, gjëza, fjalë të urta); • revista për fëmijë, enciklopedi me ilustrime për fëmijët, fjalorë të ilustruar; • bibliotekë digjitale me libra; • bibliotekë me libra në klasë; • filma të animuar, regjistrime audio-vizuale shfaqjesh teatrale, softuerë mësimorë nga interneti dhe mjete të tjera audio-vizuale, si dhe mjete të tjera varësisht nga qëllimi mësimor.
Normativi për kuadrin mësimor	Punën edukativo-arsimore për klasën e pestë mund ta zhvillojë: <ul style="list-style-type: none"> • profesori/arsimtari/mësuesi i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS • pedagogu i diplomuar VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato joletare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëpusë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medie të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);

I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte.
-------	--

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura**

	<i>Nxënësi /nxënësjja di dhe mund:</i>
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbëjë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojnë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.10	të ketë kujdes për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë;
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet te vetvetja dhe te të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;

V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënit;
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të silllet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjykimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit;
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
	<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;

V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **GJUHË DHE KOMUNIKIM**

Gjithsej: **100 orë**

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/-ja do të jetë në gjendje:

1. të dallojë komunikimin gojor e të shkruar dhe komunikimin në gjuhën standarde/letrare dhe dialekt/gjuhë popullore;
2. të shqiptojë drejt bashkëtingëlloret dhe zanoret dhe të zbatojë rregullat e përdorimit të theksit parafundor, fundor dhe tejfundor;
3. të njohë dhe të përdorë drejt: rasën, shquarësinë dhe pashquarësinë, numrin dhe gjininë e emrave, llojet e përemrave (dëftorë, vetorë, vetvetorë, pronorë, lidhorë, pyetës dhe të pacaktuar), mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë (gjinia, numri dhe shkalla), veta, numri, diateza, mënyra dhe koha e foljeve, llojet e ndajfoljeve (shkalla) dhe lidhëzat;
4. të kthejë lloje të ndryshme fjalish nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas;
5. të përmendë fjalë me kuptim leksikor të njëjtë, të kundërt ose të ndryshëm;
6. të identifikojë kryefjalën, kallëzuesin, përcaktorin, kundrinorin, rrethanorin në fjali dhe të krijojë lloje të ndryshme fjalish;
7. të zbatojë rregullat e përdorimit të shenjave të pikësimit, të shkronjës së parë të vogël ose të madhe, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe për shkurtimin e fjalëve (shkurtesat);
8. të lexojë me të kuptuar tekstet e shkurtra.

Përmbajtjet (dhe konceptet):

- Gjuha si mjet komunikimi (shenjat, sinjalet, simbolet, komunikimi me gojë dhe me shkrim, gjuhë standarde/letrare, dialekt/gjuha popullore)

Standardet e vlerësimit:

- Shpjegon gjuhën si sistem shenjash që përdoren për komunikim.
- Identifikon gjuhën si mjetin parësor të komunikimit dhe gjestet, shprehjet e fytyrës (mimikat), gjuhën e trupit, simbolet dhe sinjalet si mjete ndihmëse në transmetimin (përcjelljen) dhe marrjen e informacionit.
- Shpjegon dallimin ndërmjet komunikimit me gojë dhe me shkrim dhe jep shembuj të të dy llojeve.

	<ul style="list-style-type: none"> Njih (dallon) kur komunikimi është në gjuhën standarde/letrare dhe kur është në dialekt/gjuhë popullore dhe shpjegon pse. Përdor gjuhën standarde shqipe në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
<ul style="list-style-type: none"> Zanoret dhe bashkëtingëlloret 	<ul style="list-style-type: none"> Bën dallimin mes zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. I përmend zanoret në gjuhën shqipe. Shqipton drejt zanoret dhe bashkëtingëlloret.
<ul style="list-style-type: none"> Theksi 	<ul style="list-style-type: none"> Thekson saktë fjalët dyrrrokëshe dhe trerrokëshe. Thekson më fuqishëm rrokjen e theksuar kur lexon dhe flet. Tregon shembuj të fjalëve nga dialekte të ndryshme të gjuhës shqipe që ndryshojnë nga gjuha standarde për nga theksi.
<ul style="list-style-type: none"> Emrat (numri, gjinia, rasa, shquarësia dhe pashquarësia) emrat përmbledhës, emrat e lëndës, emrat e dygjinishëm (ambigjenë), emrat që përdoren vetëm në njëjës, emrat që përdoren vetëm në shumës 	<ul style="list-style-type: none"> Jep shembuj të emrave të gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane në numrin njëjës dhe në shumës. Jep shembuj për lakimin e emrit në trajtën e shquar dhe të pashquar. Njih emrat përmbledhës dhe emrat e lëndës në një tekst. Jep shembuj të emrave të dygjinishëm Jep shembuj emrash që përdoren vetëm në numrin njëjës. Jep shembuj emrash që përdoren vetëm në numrin shumës.
<ul style="list-style-type: none"> Përemrat (dëftorë, vetorë, vetvetorë, pronorë, lidhorë, pyetës, të pacaktuar) 	<ul style="list-style-type: none"> Njih trajtat e përemrave dëftorë në tekstin e shkruar. Përdor drejt përemrat dëftorë gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Njih trajtat e përemrave vetorë në tekstin e shkruar. Përdor drejt përemrat vetorë gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Njih trajtat e përemrave vetvetorë në tekstin e shkruar. Njih trajtat e përemrave pronorë në tekstin e shkruar. Përdor drejt përemrat pronorë gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Njih trajtat e përemrave lidhorë në tekstin e shkruar. Njih përemrat pyetës në tekstin e shkruar. Përdor drejt përemrat pyetës gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Njih përemrat e pacaktuar në tekstin e shkruar.
<ul style="list-style-type: none"> Mbiemrat (mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë, kategoria e 	<ul style="list-style-type: none"> Përcakton gjininë dhe numrin e një mbiemri sipas numrit dhe gjinisë së emrit. Identifikon mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë në një tekst.

gjinisë, e numrit dhe e shkallës të mbiemrat)	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor drejt mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. • Përdor saktë shkallët krahasore dhe sipërore të mbiemrat kur krahason dy ose më shumë frymorë ose sende.
<ul style="list-style-type: none"> • Ndajfoljet (ndajfoljet e mënyrës, sasisë, kohës, vendit) (shkallët e ndajfoljeve) 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon ndajfoljet e kohës, vendit, mënyrës, sasisë dhe shkakut në tekstin e shkruar duke bërë pyetje të përshtatshme (Kur?, Ku?, Si? Sa?). • Përdor drejt ndajfoljet e ndryshme në një fjali.
<ul style="list-style-type: none"> • Lidhëzat 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh lidhëzat në fjali. • Përdor lidhëzat gjatë hartimit të fjalive.
<ul style="list-style-type: none"> • Foljet (kategoria e vetës, numrit, diatezës, mënyrës, kohës) 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon vetën dhe numrin e foljes. • Përdor drejt trajtat e foljes në vetë dhe në numër. • Identifikon kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme të foljet. • Përdor saktë format e foljeve për kohën e tashme, të ardhme, të shkuar gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. • Identifikon dhe përdor saktë mënyrat e foljeve. • Identifikon dhe përdor saktë diatezat e foljeve.
<ul style="list-style-type: none"> • Sinonimet, antonimet dhe homonimet 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe jep shembuj fjalësh me kuptim të kundërt (antonime). • Identifikon dhe jep shembuj fjalësh me kuptim të njëjtë ose të përafërt (sinonime). • Identifikon dhe jep shembuj fjalësh që shkruhen njëjtë, por kanë kuptime të ndryshme (homonime).
<ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i figurshëm i fjalëve, shprehjeve dhe fjalive 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe interpreton fjalët, shprehjet dhe fjalitë me kuptim të figurshëm.
<ul style="list-style-type: none"> • Fjalja dhe gjymtyrët e fjalisë (kryefjala, kallëzuesi, përcaktori, kundrinori, rrethanori) 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen kryefjalë dhe kallëzuesin në fjali. • Shpjegon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali. • Njeh dhe gjen përcaktorin, kundrinorin dhe rrethanorin në fjali. • Krijon fjali me kryefjalë dhe kallëzues.
<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë 	<ul style="list-style-type: none"> • Shndërron (kthen) në ligjëratë të zhdrejtë një fjali pyetëse dhe nxitëse nga ligjërata e drejtë.

	<ul style="list-style-type: none"> • Shndërron (kthen) në ligjëratë të zhdrejtë një fjali në kohën e tashme ose të ardhme nga ligjëratë e drejtë. • Veçon replikat (pyetje-përgjigje) e ligjëratës së drejtë nga një tekst i shkruar në ligjëratën e zhdrejtë. • Ritregon një ngjarje duke përdorur ligjëratën e zhdrejtë.
<ul style="list-style-type: none"> • Shenjat e pikësimit (thonjëzat, tri pikat, kllapat dhe shenjat e tjera të ligjëratës së drejtë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe emërton shenjat e pikësimit (thonjëza, dy pika, tri pikat, kllapa) në tekst. • Përdor saktë shenjat e pikësimit gjatë të shkruarit.
<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i shkronjës së parë të madhe dhe të vogël 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh përdorimin e saktë dhe të gabuar të shkronjës së parë të madhe dhe të vogël në tekste të ndryshme. • Shkruan drejt shkronjën e parë të madhe të emërtimeve gjeografike, tek emërtimet e festave, të adresave dhe kur i drejtohem dikujt me respekt. • Shkruan drejt shkronjën e parë të vogël tek emërtimet e popujve dhe banorëve të vendeve dhe të kontinenteve. • Shkruan saktë shkronjën e madhe ose të vogël nistore tek emrat e qyteteve dhe fshatrave dhe të datave.
<ul style="list-style-type: none"> • Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit 	<ul style="list-style-type: none"> • E ndan saktë fjalën në rrokje kur bart një pjesë të saj në rreshtin tjetër. • Shpjegon se si ndahet një fjalë dhe si pjesa tjetër kalon në rreshtin e ri.
<ul style="list-style-type: none"> • Shkurtesat (shkurtime fjalësh) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh një shkurtime në fjali dhe e emërton atë në formë të plotë. • Përdor format e sakta të shkurtesave në tekstin e shkruar.
<ul style="list-style-type: none"> • Të lexuarit me të kuptuar 	<ul style="list-style-type: none"> • U përgjigjet pyetjeve rreth një teksti që lexon në heshtje për një kohë të caktuar. • Përmbledh një tekst të lexuar me veçori të ndryshme gjuhësore dhe stilistike (tekst gazete, kumtesë, njoftim, deklaratë, shpallje, tekst nga një revistë shkencore-popullarizuese). • Shprehin qëndrimin e tyre për temën e një teksti të lexuar dhe e argumenton atë me një citim nga teksti.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):¹

- Nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe secili grup vendoset në një kolonë. Nxënësi i parë në grup thotë një tingull, i dyti e shkruan me shkronjë, i treti nga shkronja thotë një fjalë dhe i katërti harton një fjali duke përdorur atë fjalë. E njëjta procedurë përsëritet katër herë, ku nxënësit ndryshojnë pozicionin në kolonë. Të gjitha grupet punojnë njëkohësisht, në të njëjtën mënyrë. Pas punës në grupe, në një diskutim të hapur arrihet në përfundimin se gjuha është një sistem shenjash (tingujsh, shkronjash, fjalësh dhe fjalish) që përdoren për komunikim (p.sh. për të folur me prindërit, me të afërmit, për të bërë biseda telefonike me miqtë, për të lexuar mesazhe dhe libra, për të shkruar dëshirat, detyrat e shtëpisë, tekstet e revistave për fëmijë etj.).
- Nxënësit ndahen në katër grupe. Një grup tregon shembuj të shprehjeve të fytyrës (mimikave), gjesteve dhe lëvizjeve të trupit që mund të nxisin konflikt (p.sh. *nxjerrja e gjuhës jashtë, lëvizje të caktuara kërcënuese me duar, nënvlerësuese, fyese...*). Grupi i dytë i nxënësve tregojnë shembuj të shprehjes joverbale që ndikon pozitivisht në marrëdhëniet me të tjerët (p.sh. *duke tundur kokën, duke buzëqeshur, duke treguar me gishtin e madh lart ose një rreth me gishtin e madh dhe tregues si shenjë e një pune të kryer mirë, duartrokite etj.*). Grupi i tretë rendit simbolet që përcjellin mesazhe (p.sh. *emotikone, trëndafila të kuq, një zemër e vizatuar, një kryq i kuq dhe një gjysmëhënë e kuqe*). Grupi i katërt i tregon sinjalet e përdorura për transmetimin e mesazheve (*drita e kuqe dhe e gjelbër, raketa sinjalizuese, zilja e shkollës*). Përmes diskutimit arrihet në përfundim se nëse komunikimi verbal nuk shoqërohet me komunikim joverbal, është më e vështirë të kuptohet mesazhi që përcillet dhe se simbolet e sinjalet shërbejnë gjithashtu si ndihmës në transmetimin dhe marrjen e informacionit.
- Nxënësit të ndarë në grupe, paraqesin situata të ndryshme në 24 orët e fundit kur dhe si kanë komunikuar me të tjerët. Më pas ata i ndajnë situatat në dy kategori: njëra nënkupton komunikimin verbal - **a). me gojë**: (p.sh. bisedë me vëllain/motrën gjatë kohës së drekës, bisedë në telefon me një shok/shoqe, duke kërkuar informacion nga shitësi në shitore, duke iu përgjigjur pyetjeve me gojë gjatë orës së mësimt) dhe komunikime të tjera **b). me shkrim**: (shkrimi i mesazheve SMS, "chat" në Instagram, "post" në Facebook, postë elektronike). Secili grup lexon disa shembuj të dy llojeve të komunikimit dhe përmes një diskutimi të hapur perceptohet ndryshimi midis tyre.
- Nxënësit ndahen në dy grupe. Nxënësit e grupit të parë ndahen në nëngrupe dhe secili nëngrup mendon një dialog të shkurtër mbi një temë nga jeta e përditshme në një dialekt që flasin në shtëpi ose që e flasin familjarët / fqinjët / miqtë e tyre. Pastaj e prezantojnë para shokëve të grupit të dytë të cilët e shkruajnë në gjuhën standarde shqipe dhe disa prej tyre e prezantojnë para shokëve të grupit të parë. Procedura përsëritet me nëngrupe të tjera të reja të grupit të parë. Në fund renditen fjalët nga dialogu që janë shkruar ndryshe. Në këtë mënyrë konstatohet se çfarë dallimi ka midis dialektit të përdorur dhe gjuhës standarde (p.sh. në shqiptimin e fjalëve, në tingujt e fjalëve etj.).
- Nxënësit dëgjojnë fjalimin e regjistruar në të cilën folësi njëherë thekson gabimisht fjalët me dy rrokje dhe me tri rrokje, kurse herën tjetër thekson saktë. Nxënësit "votojnë" pas çdo fjale të dëgjuar nëse theksohet dhe shqiptohet saktë apo jo. Mësuesi shpjegon se parregullsia në shqiptim është për shkak të theksit të pasaktë dhe u paraqet rregullat e theksit: në fjalët e përbëra nga dy rrokje (p.sh. *dritë, dórë, kështú* etj.), kurse në fjalët trerrokëshe, (p.sh. *fletóre, rrugíca* etj.). Më pas nxënësve u jepet një listë me fjalë dyrrokëshe dhe trerrokëshe për t'i ndarë në

¹Përveç shembujve të aktiviteteve të dhëna këtu, arritja e standardeve të vlerësimit nga kjo temë sigurohet edhe përmes integritit të tyre në aktivitetet e temave të tjera, veçanërisht kur bëhet fjalë për zbatimin e njohurive nga gramatika në situata praktike gjatë të shkruarit, të lexuarit dhe gjatë të folurit.

rrokje dhe për të shënuar rrokjen që theksohet. Në fund nxënësit lexojnë me zë fjalët nga lista, së pari duke ua vendosur theksin në vendin e duhur dhe më pas duke e theksuar me zë rrokjen e theksuar.

- Mësimdhënësi lëshon incizim me rrëfime të treguara në të folme të ndryshme dialektore të gjuhës shqipe (p.sh. e folmja e Dervenit, e fomja e Karadakut, e folmja e Prespës etj.). Nxënësit dëgjojnë rrëfimet dhe identifikojnë dhe shkruajnë fjalë që janë të theksuara ndryshe nga rregulli i gjuhës standarde. Pas çdo rrëfimi të dëgjuar, disa nxënës tregojnë një shembull të fjalëve të identifikuara në një dialekt dhe të tjerët i tregojnë ato në gjuhën standarde (p.sh. vëri-veri, njëri-njeri, qiri-qiri etj.).
- Nxënësve u jepet një fletë pune që ka dy kolona - njëra e shënuar si njëjës dhe tjetra si shumës. Në kolonën e majtë janë renditur një numër emrash në njëjës (në tri gjini), për të cilët nxënësit, në kolonën e djathtë, duhet të shkruajnë formën në shumës (midis tyre ka emra që nuk kanë shumës). Gjithashtu, në kolonën e djathtë renditen një numër i madh emrash në shumës (nga të tri gjinitë), për të cilët nxënësit, në kolonën e majtë, duhet të shkruajnë formën në njëjës (midis tyre ka emra që nuk kanë trajtë njëjësi). Në mes dy kolonave tregojnë nëse emri është i gjinisë mashkullore, femërore apo asnjëse. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit fillimisht lexojnë emrat për të cilët nuk kanë specifikuar shumësin, pra emrat për të cilët nuk kanë përdorur njëjësin dhe shpjegojnë pse nuk kanë përdorur. Më pas lexojnë emrat me njëjësin dhe shumësin e përdorur dhe tregojnë se në cilën gjini janë. Në një diskutim të hapur arrihet në përfundim se shumica e emrave kanë njëjës dhe shumës, por gjithashtu ka edhe emra që dalin gjithmonë vetëm në njëjës (p.sh. *dashuri, guxim, uthull, breshër, vapë, rërë, fruth, perëndim, jug, shqipja, latinishtja*) dhe ata që dalin gjithmonë në shumës, pavarësisht nëse i referohen një ose më shumë sendeve (p.sh. *pantallona, syze*).
- Mësimdhënësi shpjegon se çfarë janë emrat e dygjinishëm (ambigjienë). Nxënësve, të ndarë në grup, u jepet një listë me emra të ndryshëm, ndër të cilët ka edhe emra të dygjinishëm (p.sh. *mal-male; ujë-ujëra; shi-shira; fshat-fshatra, vend-vende, mall-mallra*). Detyra e tyre është që t'i nënvizojnë emrat e dygjinishëm dhe t'i shkruajnë ato në fletore. Më pas, nga një nxënës prej secilit grup, lexon emrat që kanë veçuar.
- Nxënësve, të ndarë në dyshe, u jepen fjali në të cilat emrat përdoren në njëjës, shumësi i të cilëve ka forma të parregullta, pra bëhen me ndryshim të tingujve (p.sh. *ka -qe, lepur-lepuj, dash-desh, shteg-shtigje, mik-miq*). Nxënësit duhet t'i kthejnë emrat në shumës dhe të bëjnë fjali të reja me to.
- Mësimdhënësi shpjegon se çfarë janë emrat përmbledhës dhe çfarë janë emrat e lëndës. Nxënësve, të ndarë në dyshe, u jepet një listë me emra përmbledhës (p.sh. *djalëria, graria, rinia, beqaria*) dhe emra e lëndës (p.sh. *djathë, kripë, sheqer, dhallë, qumësht, miell, hekur, plastikë, qelq, rërë*) në një rend të përzier. Detyra e tyre është të shënojnë veç e veç edhe njërin lloj të emrave, edhe llojin tjetër. Më pas lexohen veçmas emrat përmbledhës, pastaj emrat e lëndës. Nxënësit kërkojnë cilët nga këto emra përdoren gjithmonë në njëjës.
- Mësimdhënësi paraqet përemrat dëftorë: *ky / kjo / këta / këto, ai / ajo / ata / ato*. Nxënësve u jepet një tekst ku janë përdorur të gjithë përemrat dëftorë në gjini dhe numër të ndryshëm dhe kanë për detyrë të gjejnë, të nënvizojnë dhe të përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre. Pasi lexojnë përemrat dëftorë të identifikuar, përmes diskutimit përfundojnë se kur përdoret secila nga këto (p.sh. për të vënë në dukje njerëzit dhe sendet që janë pranë apo larg). Nxënësit, të ndarë në grupe, formojnë fjali ku përdoren përemrat dëftorë, pastaj i thotë me gojë dhe i shkruan në fjali. (I njëjti aktivitet përdoret edhe për përemrat vetorë, vetvetorë, pronorë, lidhorë dhe të pacaktuar).
- Nxënësit ndahen në tri grupe. Njëri është grupi *Kush? / Cili? / Cila?*, tjetri është grupi *i kujt? / i cilit? / i cilës?* dhe i treti është *Çfarë? / Çka? / Ç'?*.

Mësimdhënësi lexon një fjali dhe secili grup mendon një pyetje që fillon me përemrin pyetës që ka grupi i tyre. Për disa prej fjalive që të tria grupet do të jenë në gjendje të mendojnë pyetje (p.sh. *Arianit i humbi lapsi. - I kujt është lapsi? Kush e humbi lapsin? Çfarë humbi Ariani?*). Për disa fjali vetëm dy grupe do të mendojnë pyetje dhe për disa fjali vetëm njëri grup. Më pas, secilit grup i jepet një listë me fjali të shkruara në të cilat përdoren përemrat pyetës. Detyra e tyre është t'i identifikojnë dhe përcaktojnë sipas gjinisë dhe numrit. Saktësia e përgjigjeve të dhëna kontrollohet nëpërmjet një diskutimi të hapur të drejtuar nga mësimdhënësi.

- Nxënësve në dyshe u jepet një fletë me fjali (p.sh. *E piva edhe gotën e dytë me lëng të shijshëm; Ditën e tretë vizitua muzeun e qytetit*). Nxënësit ndajnë numëroret (mbiemrat marrëdhëniorë) dhe diskutojnë për gjininë dhe numrin e tyre. Kontrollojnë detyrën me zë të lartë. Më pas, secila dyshe parashtron një pyetje dhe përgjigje në të cilën përdoret një numëror (mbiemër marrëdhënior) i shënojnë dhe i lexojnë para të tjerëve. Në fund, zakonisht arrihet në përfundimin se numri dhe gjinia e numërorëve (mbiemrave marrëdhëniorë), pavarësisht llojit të tyre, varet nga numri dhe gjinia e emrave të cilëve u referohen.
- Mësimdhënësi përmes një prezantimi pamor (video) tregon fotografi nga ekspozitat e muzeut dhe galerive, ku prezantohen objekte dhe punime të punuara me materiale të ndryshme, si: dru, metal, bronz, bakër, qelq, plastikë, gur, mermer, pëlhurë, letër etj., në secilën fotografi ka të dhëna për ekspozitën, duke përfshirë materialin e përdorur. Pas çdo fotografie të paraqitur, nxënësit përshkruajnë eksponatet sipas materialit nga i cili janë bërë (p.sh.: *vazo prej bronzi - vazo e bronzte; kapelë prej letre – kapelë letre; derë prej hekuri – derë e hekurt; shtyllë prej mermeri – shtyllë e mermertë*). Në fund, mësuesi vë në dukje se në përshkrimin e eksponateve përdoren mbiemrat marrëdhëniorë (marrëdhënie lëndore).
- Nxënësit në grup përdorin Google Maps për të identifikuar distancën midis vendbanimit të tyre dhe pesë qyteteve të tjera në vend. Bazuar në informacionin e marrë, ata hartojnë fjali në të cilat krahasojnë gjatësinë e rrugës nga vendi i tyre deri te vendet e tjera, duke përdorur mbiemrat e mëposhtëm: *rruga e gjatë- e shkurtër dhe rruga më e shkurtër-më e gjatë, jashtëzakonisht e shkurtër – jashtëzakonisht e gjatë*. (p.sh.: *Rruga Jegunovcë-Tearcë është më e shkurtër, sesa rruga Jegunovcë-Dibër. Më e gjata është rruga Jegunovcë - Gjevgjeli. Jashtëzakonisht e gjatë është rruga Jegunovcë - Stamboll*). Pastaj përdorin shkallët e mbiemrave edhe për shembujt: *i/e lartë, i/e ulët, i/e thellë, i/e cekët* etj. në fjali që krahasojnë malet, lumenjtë, liqenet e të tjera rreth tyre.
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një fletë pune në të cilën janë shkruar: ndajfoljet e mënyrës, e sasisë, e kohës, e vendit (*tash, sonte, së shpejti, drejt, majtas, djathtas, andej, këndeje, përpara, më tutje, kurrkund, asgjëkund, më pas, më në fund, shumë, pak, lehtë, vështirë, qartë, mirë, keq, shpejt, me kujdes, ngadalë, bujarisht, trimërisht, mbrëmë, sot, nesër, vonë, herët, aq, kaq, tepër*, etj.) Secili grup tërheq një copë letër në të cilën janë shkruar tema të ndryshme (p.sh. *Si të arrijmë deri në ...; Shkojmë në ekskursion; Do të festojmë ditëlindje*) dhe atyre u jepet detyrë të mendojnë për një tekst / dialog (rreth 10 fjali) për temën që kanë tërhequr dhe duhet të përdorin sa më shumë që mundën ndajfoljet e dhëna në fletën e punës. Pasi lexojnë atë që është shkruar, u jepet një detyrë e re: T'i ndajnë në katër grupe me pyetjet e dhëna: *Kur?, Ku?, Si?* dhe *Sa?*. Më pas identifikojnë se në cilin grup bëjnë pjesë llojet e ndajfoljeve që kanë përdorur në tekst, gjithashtu gjejnë dhe shkallët e ndajfoljeve. Me diskutimin vijmë në përfundim se grupimi i bërë përshtatet me llojet e ndajfoljeve (ndajfoljet e kohës, vendit, mënyrës dhe sasisë).
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, krijojnë fjali nga pjesët e fjalive të renditura në dy kolona. Pas kësaj për secilën pjesë të fjalisë së shkruar në kolonën e majtë, ata gjejnë pjesën e duhur të shkruar në kolonën e djathtë dhe identifikojnë se cila nga lidhëzat (*dhe, a, por, sepse, pse, për arsye se, për*

shkak se, po, për, kur) të shkruara nën kolonat sigurojnë fjali logjike. Nxënësit lexojnë përgjigjet dhe me ndihmën e mësuesit përcaktojnë saktësinë e tyre.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, hedhin dy zara – në njërin shkruhen tri vetat (nga dy herë) dhe në tjetrin të dy numrat (nga tri herë). Mësimdhënësi thotë një folje dhe nxënësi që hedh zarin në grupin e tij krijon një fjali me foljen në vetë dhe në numër si që i bie te zari. Më pas mësimdhënësi thotë një folje tjetër dhe nxënësi tjetër në secilin grup hedh zarin dhe thotë një fjali me atë folje. Procedura përsëritet me të gjithë nxënësit.
- Nxënësve u jepet një tekst që përdor folje në kohë të ndryshme. Nga ata pritet të gjejnë foljet dhe t'i vendosin në një tabelë me tri kolona: koha e tashme, e shkuar dhe e ardhmja. Më pas përdorin të njëjtat folje për të bërë fjali të reja, por këtë herë ndryshojnë kohën e foljes. Një pjesë e fjalive të reja të krijuara lexohen me zë.
- Mësimdhënësi shpjegon se si dhe kur përdoren mënyrat e foljeve: urdhërore, dëshirore, habitore, lidhore . Më pas nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup zgjedh të mendojë dhe të shkruajë dhjetë fjali në formën urdhërore, dëshirore, habitore ose lidhore që jep udhëzime se si të bëhet një sanduic (p.sh. *Pritini dy copa bukë. Merr gjalpin nga frigoriferi ...*), si rregullohet dhoma (p.sh. *Hiqi rrobat nga dyshemeja. Vendosi në dollap....*), ose si një grup nxënësish të arrijnë nga klasa në sallën e sportit (p.sh. *Ngrihuni prej vendi. Shkoni te dera. Dilni nga klasa. Kthehuni në të djathtë pas korridorit...*), urata (*Rrofsh sa malet. Jetofsh i lumtur.*), kur habitemi (*Paskan ardhur shoqet!, Sa shumë qënke rritur!*) Pasi grupet do ta prezantojnë atë që është shkruar, përmes diskutimit arrihet në përfundimin se forma urdhërore e foljes shprehet në vetën e dytë njëjës dhe shumës.
- Mësimdhënësi njofton se do të luajnë një lojë për antonimet. Mësimdhënësi thotë një fjalë për të cilën ka një fjalë tjetër, por me kuptim të kundërt dhe u jep atyre gjysmë minutë për të shkruar fjalën me kuptimin e kundërt në një fletë që e kanë përpara tyre. I njëjti veprim përsëritet për më shumë fjalë (p.sh. *i madh, e gjatë, i mirë, e shëmtuar, i zi, e zgjuar, i ri etj.*). Një nxënës lexon listën e fjalëve të reja të shkruara dhe të tjerët kontrollojnë nëse kanë shkruar të njëjtat fjalë. Mësimdhënësi ndërhyr nëse ka nevojë për korrigjim. Më pas, një nxënës tjetër lexon sërish (një nga një) listën e fjalëve të reja të shkruara, por këtë herë për secilën prej tyre thotë fjalën me kuptimin e kundërt që është lexuar më parë nga mësimdhënësi. Në fund mësimdhënësi thekson se fjalët me kuptime të kundërta quhen **antonime**.
- Nxënësit të ndarë në grupe të vogla garojnë duke luajtur lojën *Kujtesa*. Mësimdhënësi vizaton në dërrasë, një tabelë me 20 fusha të titulluara *Sinonime*. Për lojën përdor 20 fletë që janë shkruar 10 çifte fjalësh me kuptim të njëjtë ose të përafët (p.sh. *mjek - doktor; mësimdhënës - arsimtar; vajzë- çupë; djalë - çun; e zonja – e aftë; i gjelbëruar – i bleruar; rrugë - udhë; shtëpi - banesë; habit- mahnit; fshat - katund*). Grupet hapin në mënyrë të pavaruar nga dy fusha dhe marrin pikë nëse kanë përputhur fjalët me kuptim të njëjtë ose të përafërt. Pas çiftëzimit të të gjitha fjalëve, mësimdhënësi vë në dukje se fjalët e çiftuara, quhen **sinonime**.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune (me titull *Homonime*) ku renditen fjalitë që janë përdorur fjalë që kanë homonime të përshtatshme (p.sh. *Ajo veshi fustanin. Sot më dhemb veshi; Dje patë ditëlindjen. Në oborr kemi plot patë.; Bari është rritur. Gjyshi im është bari.*) dhe u jepet detyrë të zbulojnë fjalën në secilën prej fjalive që ka një kuptim tjetër dhe për të bërë një fjali të re me atë fjalë që do të pasqyrojë kuptimin tjetër. Ata i lexojnë fjalitë me zë dhe së bashku arrijnë në përfundimin se fjalët që shkruhen njëjloj, por kanë kuptime të ndryshme, quhen **homonime**.
- Nxënësit punojnë në grup me detyrë të njohin fjalët dhe shprehjet e fjalëve me kuptim të figurshëm dhe të riformulojnë fjalinë duke përdorur

fjalët/shprehjet nga të cilat dallohet kuptimi i drejtpërdrejt (p.sh.: *Ekipi zbret në fund të tabelës. – Ekipi është në vendin e fundit të tabelës .; Ai uli kokën përpara shokut. – Ai u turpërua para shokut.*). Grupet lexojnë me zë fjalitë e sapopërpiluara dhe të gjithë së bashku diskutojnë për shprehshmërinë e tekstit në të cilin janë përdorur fjalë/shprehje me kuptim të figurshëm dhe arrihet në përfundimin se fjalë/shprehje të tilla tërheqin më shumë vëmendjen e lexuesit dhe lënë përshtypje më të fortë. Në fund mësimdhënësi paraqet fjali me kuptim të figurshëm (p.sh.: *Fjala e bukur hap dyerë të hekurta*) dhe në diskutim nxënësit interpretojnë kuptimin e tyre.

- Mësimdhënësi shpjegon se çfarë është kryefjala dhe çfarë është kallëzuesi, duke përdorur si shembull disa fjali. Nxënësit në çift marrin një fletë pune me fjali të shkruara (p.sh. *Drita hyri në dhomë; Unë e lexova tekstin.*). Nxënësit gjejnë dhe rrethojnë kryefjalën, më pas gjejnë dhe nënvizojnë kallëzuesin në secilën fjali dhe i shkruajnë në kolona të veçanta. Më pas lexojnë me zë të lartë se çfarë kanë shkruar në kolonën *Kryefjalë* dhe çfarë në kolonën *Kallëzues*. Kështu kontrollohet saktësia e përgjigjeve të dhëna. Në fund diskutohet se cili është roli i kryefjalës dhe cili është roli i kallëzuesit në fjali.
- Nxënësve u jepet një fletë pune në të cilat janë shkruar skema fjalish, sipas të cilave duhet të formulojnë fjali. Në skemat e fjalisë, është dhënë një sqarim për renditjen specifike të gjymtyrëve të fjalisë (p.sh.: *kryefjalë + kallëzues + rrethanori; kryefjalë (kryes i veprimit) + kallëzues (veprimi) + rrethanori (i kohës, i vendit, shkaku...etj.)*). Nxënësit lexojnë shembujt dhe shpjegojnë rrethanorin e përdorur në secilën fjali.
- Nxënësit, në çift, tërheqin tre letra me folje të ndryshme të shkruara në to (nga një në secilën fletë). Detyra e tyre është të shkruajnë një fjali me një nga foljet e zgjedhura me kryefjalë të njëjtë ose të ndryshme. Fillimisht lexojnë fjalitë dhe më pas i plotësojnë rrethanorët.
- Mësimdhënësi paraqet fjali pyetëse dhe urdhërore dhe fjali në kohën e tashme dhe të ardhme, të gjitha të shkruara në të ligjëratën e drejtë (duke i zbatuar rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit). Nxënësit i kthejnë në ligjëratë të zhdrejtë. Ata thonë gojarisht 2-3 fjalitë e para të shndërruara (kthjera) dhe 2-3 fjalitë e tjera i shkruajnë në një letër. Lexohen fjalitë e shkruara dhe komentohet nëse janë të shkruar saktë.
- Nxënësve u jepet një tekst të shkruar në të ligjëratën e zhdrejtë që tregon një dialog midis dy shokëve/dy shoqeve. Nxënësit në çift e shndërrojnë në ligjëratë të drejtë dhe shkruajnë replikën (pyetje-përgjigjet) në dialog, duke respektuar shenjat e pikësimit. Disa çifte luajnë dialogun sipas bisedave të shkruara. Një nxënës e shkruan dialogun në dërrasë dhe të tjerët kujdesen që shenjat e pikësimit të përdoren saktë.
- Mësimdhënësi disa nxënësve u jep një tekst të shkurtër dramatik për një ngjarje të caktuar në shkollë për ta interpretuar para të tjerëve. Më pas nxënësit (në mënyrë të pavarur) ritregojnë historinë duke përdorur të ligjëratën e zhdrejtë. Disa nxënës lexojnë atë që kanë shkruar, pastaj krahasojnë çfarë është e ngjashme dhe çfarë është e ndryshme në ritregimin e tyre.
- Nxënësve u jepet një fletë pune ku janë dhënë shenjat e pikësimit dhe ka fjali të shkruara ose togfjalësha, në të cilat shenjat e pikësimit janë hequr ose janë përdorur gabimisht dhe shkronjat e mëdha dhe/ose të vogla janë përdorur gabimisht. Detyra e nxënësve është të identifikojnë gabimet dhe t'i korrigjojnë ato në tekst. Më pas, disa nxënës i shkruajnë fjalitë/togfjalëshat ashtu siç mendojnë se janë të sakta dhe të tjerët pajtohen ose nuk pajtohen me atë që është shkruar. Në fund mësimdhënësi tregon se cila shenjë e pikësimit është e gabuar dhe cila është

përdorur saktë dhe shpjegon pse. Në fund mësimeve shpjegon përdorimin e shkronjave të mëdha dhe të vogla. (Në të njëjtin parim mund të krijohet një veprimtari për të zbatuar rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit).²

- Nxënësit praktikojnë rregullat e drejtshkrimit të vendosura në mënyrë elektronike nëpërmjet një kuizi (nëpërmjet mentimetrit ose formularëve google). Kuizi i dhënë në linkun e mëposhtëm mund të shërbejë si model: https://quizizz.com/admin/quiz/5e6e7c24a563ee001b46be25/-?fbclid=IwAR1j7ygam744waow29oEhdKrLu5E1GUaTZ432G4Nps5y6xT8K_S5jBe4xNI
- Nxënësve në çift u jepet një fletë pune me fjalë të shkruara në një kolonë dhe shkurtesat e tyre në një kolonë tjetër, në një rend të përzier (p.sh. shkurtesat **SHF** - shkolla fillore, **KTP**-Kompania e Transportit Publik, **BE**-Bashkimi Evropian dhe shkurtesat e fjalëve **f.** -faqe, **etj.** – e tjerë, **d.m.th.** – domethënë ...). Nxënësit duhet të lidhin fjalët me shkurtesat e duhura dhe të kontrollojnë me njëri-tjetrin nëse kanë bërë lidhjen e duhur.
- Nxënësit lexojnë individualisht një tekst joletrar të shkruar në stilin shkencor-popullor dhe më pas e përmbledhin atë (në formë të shkruar) duke paraqitur shkurtime të dhënave/informacionet (së bashku me tabelat/grafikët/diagramet) dhe interpretimet e tyre që përmban teksti. Disa nxënës prezantojnë atë që është shkruar dhe bashkërisht diskutohet nëse të gjitha informacionet/të dhënat e rëndësishme dhe interpretimet e tyre janë përfshirë në tekstet e paraqitura.
- Nxënësit lexojnë individualisht një tekst më të gjatë (1-2 faqe) me temën *Në trup të shëndoshë, shpirti i shëndoshë*. Detyra e tyre është të bëjnë shënime që përmbledhin tekstin. Më pas ata shprehin qëndrimin e tyre për temën dhe e mbështesin atë me një citat nga teksti. Pasi disa nxënës do ta lexojnë atë që kanë shkruar, në diskutim e lidhin tekstin me situatat nga jeta e përditshme.

Fusha programore: **LETËRSI DHE KRIJIMTARI**

Gjithsej: **70 orë**

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. t'i dallojë tekstet letrare sipas formës në të cilën janë shkruar (poezi, prozë dhe dramë);
2. të analizojë dhe të interpretojë në mënyrë të argumentuar tekstet letrare dhe tekstet nga krijimtaria popullore;
3. të ritregojë tekste, të tregojë (me gojë e me shkrim) dhe të krijojë tekste për një temë të caktuar nga mësuesi/ja ose për një temë të lirë.

Nxënësi/nxënësja do të zhvillojë:

1. të menduarit kritik nëpërmjet leximit dhe analizës së teksteve;
2. kreativitetin nëpërmjet të shprehurit me shkrim.

² Sa herë që kryhet një veprimtari me shkrim, pavarësisht se cili standard vlerësimi synohet, kontrollohet përdorimi i rregullave drejtshkrimore duke korrigjuar gabimet e bëra.

Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none"> Leximi dhe interpretimi i teksteve në prozë (tregim, roman, rrëfyes, përmbajtje, ngjarje, personazh, temë, kohë, vend, ide) 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon elementet e një teksti në prozë (rrëfyesin, personazhet, përmbajtjen, temën, kohën, vendin dhe idenë) nëpërmjet analizës së tekstit. Shpjegon marrëdhënien shkak-pasojë midis ngjarjeve në një tekst në prozë. Përshkruan tiparet dhe veprimet karakteristike të personazheve dhe marrëdhëniet ndërmjet personazheve në një tekst në prozë dhe i shpjegon ato nëpërmjet citimeve që i nxjerr vetë. Interpreton idetë në një tekst dhe shpreh qëndrimin e vet ndaj një ideje.
<ul style="list-style-type: none"> Leximi dhe interpretimi i vjershave për fëmijë (motiv, vjershë humoristike, vjershë peizazhi, vjershë patriotike, varg, strofë, rimë, imazh poetik) 	<ul style="list-style-type: none"> Lexon dhe reciton në mënyrë shprehëse vjersha për fëmijët. Identifikon një motiv në vjershën për fëmijë dhe dallon llojin e vjershës sipas motivit (humoristike, e peizazhit dhe patriotike). Analizon kompozicionin e një vjershe të caktuar (vargjet, strofat dhe rimën). Identifikon imazhet poetike dhe ato i mbështet me vargje të vjershës.
<ul style="list-style-type: none"> Leximi dhe interpretimi i teksteve Dramatike (personazh, dialog, monolog) 	<ul style="list-style-type: none"> Lexon në mënyrë shprehëse një tekst drame. Identifikon elementet e një teksti të dhënë dramatik: personazhet dhe veprimin dramatik. Shpjegon dallimin ndërmjet dialogut dhe monologut në një tekst dramatik.
<ul style="list-style-type: none"> Krijimtaria popullore (poezi popullore, kallëzime/rrëfime popullore) 	<ul style="list-style-type: none"> Bën dallimin midis krijimtarisë letrare dhe asaj popullore sipas autorësisë, përmbajtjes dhe gjuhës.
<ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi, ritregimi, tregimi dhe krijimi i teksteve të shkurtra 	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan personazhe, peizazhe, dukuri, objekte (reale dhe të imagjinuara). Ritregon përmbajtjen e një teksti të lexuar si tërësi ose në pjesë të tij, sipas një plani të caktuar ngjarjesh në tekst. Tregon një ngjarje nga përvoja e vet. Tregon sipas një teksti hyrës të dhënë dhe mendon një përfundim të ri të një teksti të dhënë.

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">• Krijon tekste me struktura të thjeshta kompozicioni për një temë të lirë ose të dhënë, duke respektuar rregullin për pjesën hyrëse, kryesore dhe përfundimtare të tekstit dhe duke iu përmbajtur rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.• Shkruan një tekst të shkurtër ose shpjegon me gojë (sipas planit dhe shënimeve të tij/të saj) se pse i pëlqen ose jo një tekst i caktuar letrar. |
|--|--|

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

- Nxënësve u jepet një fletë pune me dy tekste në prozë (pjesë të nxjerra nga dy tregime) - te njëra rrëfëhet tregimi në vetën e parë, kurse te tjetra në vetën e tretë. U kërkohet nxënësve të nënvizojnë foljet në të dyja tekstet. Gjatë diskutimit krahasohen trajtat foljore te njëri dhe te teksti tjetër dhe bëhet dallimi midis dy llojeve të rrëfyesve: në vetën e parë dhe në vetën e tretë.
- Nxënësit lexojnë individualisht një tregim të shkurtër. Pastaj ata, të ndarë në grupe nga gjashtë veta, tërheqin nga kompleti i fletëzave në të cilat shkruhet (në secilën fletëz nga një): *PËRMBAJTJA: Ritrego tregimin, TEMA: Për çfarë rrëfëhet në këtë tregim?; PERSONAZHET: Cilët janë personazhet e tregimit?; KOHA: Kur ndodhin ngjarjet?; VENDI: Ku zhvillohen ngjarjet?; IDEJA: Cili është mesazhi i tregimit?* Çdonjëri në grup u përgjigjet pyetjeve/kërkesave që ai/ajo ka tërhequr, kurse të tjerët dëgjojnë dhe, nëse është e nevojshme, mund të shtojnë ose të korrigjojnë. Pas përfundimit të punës në grup, mësimmthënësi bën pyetje për secilin element të tregimit dhe nxënësit e grupeve të ndryshme u përgjigjen atyre. Në fund, ata së bashku nxjerrin përfundimin se cilat janë elementet e tregimit (edhe të çdo teksti tjetër në prozë) dhe si zbulohen ato gjatë analizës së tekstit.
- Nxënësit, pasi e kanë lexuar në shtëpi një tekst në prozë nga një lekturë e caktuar dhe e kanë ritreguar përmbajtjen e tekstit në fletore, e bëjnë analizën në klasë. Secili nxënës u përgjigjet edhe me shkrim pyetjeve për elementet e tjera të tekstit: rrëfyesi, personazhet, tema, koha, vendi dhe ideja. Mandej nxënësit lexojnë atë që kanë shkruar (disa nxënës për secilin element), kurse gjatë kësaj kohe të tjerët bëjnë plotësime ose korrigjime (sipas nevojës).
- Nxënësit lexojnë individualisht një tregim të shkurtër që përshkruan disa ngjarje me radhë. Pas leximit, ata ndahen në grupe dhe brenda grupit identifikojnë ngjarjet në tregim dhe nxënësit një nga një tregojnë ngjarjet sipas radhës së ndodhjes së tyre. Brenda grupit, ata përcaktojnë shkaqet e ndodhjes së secilës ngjarje dhe pasojat e ndodhjes së saj, si dhe cilat personazhe dhe cilat nga veprimet e tyre përcaktojnë rrjedhën e ngjarjeve. Secili grup prezanton atë që kanë arritur të kuptojnë gjatë analizës. Pastaj bashkërisht diskutohet nëse mund të ndryshohet radha e ngjarjeve në tregim dhe cilat do të ishin pasojat e një ndryshimi të tillë dhe konstatohet se për ta kuptuar më lehtë tekstin e lexuar i renditim ngjarjet sipas radhës së ndodhjes dhe kështu i përcaktojmë marrëdhëniet shkak-pasojë ndërmjet ngjarjeve.
- Nxënësve u jepet detyrë të lexojnë në shtëpi një roman për fëmijë (nga lista e lekturave) dhe gjatë leximit të mbajnë shënime për tiparet e personazheve dhe ku janë përshkruar ato në roman. Gjatë punës në klasë ata ndahen në grupe - secili grup merr nga dy personazhe të romanit (grupe të ndryshme mund të punojnë në kombinime të ndryshme personazhesh), me detyrën për të përshkruar çdo personazh, duke përmendur të paktën tri nga tiparet e tij karakteristike (për sa i përket pamjes, aftësive, sjelljes). Pastaj për secilën nga veçoritë e përmendura, ai/ajo duhet të gjejë citate në roman që tregojnë se personazhi zotëron pikërisht atë veçori, kështu që ai/ajo do të rishkruajë tekstin dhe do të tregojë faqen e librit ku ndodhet. Citimet duhet t'u referohen përshkrimeve të drejtpërdrejta të tipareve të dhëna në roman dhe/ose të veprimeve të kryera nga personazhi nëpërmjet të cilave arrihet përfundimi se e ka atë tipar. Në mënyrë plotësuese, grupi përcakton marrëdhëniet midis personazheve (p.sh. nëse ata janë shokë / të afërm ..., a i kanë marrëdhëniet mes vete të mira a të këqija etj.) dhe këtë gjë e mbështet me anë të citimeve të zgjedhura. Secili grup prezanton punën e vet. [Kjo veprimtari mund të realizohet në dy orë - në njërën prej tyre bëhet analiza e njërit personazh dhe në të dytën e personazhit tjetër dhe e marrëdhënieve ndërmjet personazheve.]
- Nxënësit dëgjojnë incizime dëgjimor (audio) me recitime vjershash për fëmijë dhe mandej së bashku konstatojnë se çfarë ndryshon kur lexojnë

një vjershë nga leximi i një teksti në prozë. Më pas, të ndarë në grupe, atyre u jepet nga një vjershë për fëmijë dhe të gjithë në grup e lexojnë atë me zë, duke u përpjekur të ndjekin mënyrën e recitimit të poezisë nga audio incizimi. Secili nga grupi mëson nga një strofë përmendsh dhe së bashku recitojnë vjershën para të gjithëve. Grupet e tjera u japin njoftime prapavepruese se si e përjetuan recitimin e tyre.

- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet nga një vjershë humoristike, patriotike dhe të peizazhit nga poezia për fëmijë. Detyra e tyre është që, pas leximit të vjershave, t'i krahasojnë ato për nga motivi - të identifikojnë se cila prej tyre është humoristike, cila është patriotike e cila është vjershë peizazhi dhe të shpjegojnë pse i kanë përcaktuar si të tilla. Mandej i krahasojnë për nga kompozicioni – përmendin sa strofa ka secila vjershë dhe prej sa vargjesh ndërtohet secila strofë, si dhe përcaktojnë se cila prej tyre ka rimë dhe ku shihet ajo. Krahasimin e shkruajnë në një tabelë në të cilën ndër titullin e secilës vjershë i radhitin veçoritë e saj. Këtë analizë ata ua prezantojnë edhe të tjerëve.
- Nxënësit në dyshe lexojnë një poezi peizazhi dhe u përgjigjen me gojë pyetjeve që shërbejnë për të zbuluar motivin e vjershës (p.sh. Çfarë mendoni, pse vjersha e ka këtë titull? Çfarë ju pëlqen më shumë në të? Çfarë ndjenje humori ngjall ajo? Cilat fjalë/vargje ju kanë lënë mbresa? Pse? A mund ta paraqisni vjershën me pak fjalë? Çfarë ndjenjash shpreh? Për çfarë bukurish flet vjersha?). Në fund u bëhet kjo pyetje: Sipas asaj që u tha, cili është motivi në këtë vjershë? të cilës ata duhet t'i përgjigjen me shkrim. Disa nxënës lexojnë atë që kanë shkruar, ndërsa të tjerët komentojnë dhe plotësojnë.
- Nxënësve u jepet një fletëz pune me vargje të zgjedhura nga poezi të ndryshme për fëmijë. Detyra e tyre është që pas leximit të vargjeve t'i përgjigjen pyetjes: Çfarë u thonë këto vargje shqisave tona, çfarë mund të imagjinojmë, të dëgjojmë, të nuhasim, çfarë imazhi poetik na krijojnë vargjet? Fillimisht nxënësit duhet të gjejnë dhe të nënvizojnë fjalët që i shtyn të krijojnë imazhin për atë që thuhet në secilën prej tyre, kurse pastaj të vizatojnë figurat. Secili nxënës paraqet dhe përshkruan përpara të tjerëve nga një prej figurave që ka imagjinuar dhe thotë fjalët nga vargjet që e kanë shtyrë ta bëjë atë. Mësimdhënësi vë në dukje se figurat që kanë imagjinuar quhen imazhe poetike dhe nxënësit i krahasojnë imazhet poetike të frymëzuara nga poezitë/vargjet e ndryshme dhe shpjegojnë se nga vijnë ndryshimet midis tyre.
- Nxënësit dëgjojnë incizimet e një drame për fëmijë dhe pastaj konstatojnë së bashku se çfarë është e ndryshme kur thuhet një tekst dramatik nga mënyra se si lexohet një tekst në prozë. Të ndarë në grupe, nxënësve u jepet një tekst dramatik që së pari secili individualisht ta lexojë në mënyrë shprehëse të gjithë tekstin, duke u përpjekur të hyjë në rolin e secilit prej personazheve. Më pas i ndajnë rolet dhe e lexojnë në mënyrë shprehëse pjesën e tyre të tekstit sikur ta luanin atë rol. Secili grup u paraqet të tjerëve një pjesë të tekstit. Diskutohet se roli i kujt ishte më i vështirë për t'u shprehur me anë të leximit, kurse i kujt ishte më i lehtë dhe pse.
- Nxënësit lexojnë individualisht një fragment më të gjatë nga një tekst dramatik për fëmijë, në të cilin përveç dialogëve mes disa personazheve ka edhe një monolog. Pas leximit, ata ndahen në grupe dhe brenda grupit identifikojnë pjesët e tekstit ku personazhet flasin me njëri-tjetrin dhe ku njëri prej personazheve i drejtohet lexuesit/publikut ose i shpreh zëshëm mendimet e veta. Mësimdhënësi shpjegon dallimin ndërmjet dialogut dhe monologut dhe pastaj një grup e lexon monologun, kurse grupet e tjera i lexojnë dialogët e veçantë.
- Nxënësit shikojnë një shfaqje për fëmijë dhe pastaj gjatë bisedës i identifikojnë personazhet. Secili nxënës në mënyrë individuale e ritregon në fletore veprimin dramatik. Njëri nga nxënësit lexon atë që ka shkruar dhe të tjerët shtojnë ose korrigjojnë nëse është e nevojshme.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, kanë për detyrë të gjejnë krijime të ndryshme të letërsisë popullore. Gjatë hulumtimit të tyre ata duhet të vërejnë

se nga vijnë ato krijime, cilit zhanër i përkasin (kallëzim, këngë popullore, fjalë e urtë, gjëgjëzë) dhe çfarë urtësie (mesazhi) popullore përcjellin. Gjatë orës mësimore secili grup zgjedh nga një krijim të çdo zhanri dhe bën një prezantim rreth tyre. Materialet mblidhen dhe redaktohen si një libër më vete me titullin *Krijimtari popullore*.

- Nxënësit shikojnë një kallëzim/rrëfim popullor. Nxënësit, të ndarë në grupe, kanë për detyrë të identifikojnë dallimet midis kallëzimeve popullore dhe teksteve letrare në prozë për sa i përket gjuhës në të cilën janë shkruar dhe kush i ka krijuar. Në një diskutim të hapur konstatohet se tekstet letrare në prozë janë krijime artistike, të shkruara nga një autor. Për dallim prej tyre, kallëzimet popullore i kanë këto veçori: janë krijuar gojari (me autor të panjohur), janë përcjellë e janë ndryshuar nga një brez në tjetrin derisa dikush i ka shkruar, janë treguar në të folmen popullore dhe ato bartin traditat popullore.
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet nga një vjershë nga poezia popullore ose nga një tregim të shkurtër popullor (të ndryshëm për çdo grup). Pas leximit të tyre, grupet flasin për motivin dhe mënyrën se si paraqiten ngjarjet, dukuritë, personazhet dhe marrëdhëniet mes tyre. Pastaj secili grup së pari e lexon tregimin dhe tregon mesazhin e tij, kurse pastaj e lexon vjershën dhe tregon mesazhin e saj. Në fund mësimdhënësi fillon një bisedë për rolet tradicionale që paraqiten në krijimtarinë popullore si dhe për stereotipat gjinorë e të tjerë që janë në kundërshtim me jetën bashkëkohore.
- Në një kuti gjenden fletëzat ku janë shënuar: personazhe (p.sh. personazh filmi vizatimor ose filmi tjetër, shtriga, zana), objekte (p.sh. stacioni i trenit, këndi i lojërave për fëmijë, kështjella, anija kozmike), peizazhe (pylli në vjeshtë, bregu i liqenit në verë, mali në një planet tjetër), dukuri (p.sh. bie borë, lumë i fryrë, shi i karkalecave). Çdo nxënës tërheq nga një fletëz dhe përshkruan në fletore atë që ka tërhequr, duke përdorur sa më shumë detaje (mbiemra cilësorë). Disa nxënës e lexojnë me zë përshkrimin që kanë bërë, ndërsa të tjerët japin njoftime prapavepruese (komente).
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një tekst letrar dhe ata e lexojnë në mënyrë të pavarur. Mandej ata bëjnë një plan ngjarjesh nga teksti (i renditin ngjarjet sipas radhës). Brenda grupit, të gjithë ritregojnë me shkrim nga një ngjarje prej planit. Pas kësaj të gjithë i vendosin ngjarjet së bashku sipas radhës, i lexojnë dhe i korrigjojnë për të fituar tekstin e plotë të ritreguar.
- Nxënësve u jepet për detyrë të kujtojnë një ngjarje interesante ose emocionuese nga përvoja e tyre që ata duan t'ua tregojnë të tjerëve. Të gjithë marrin nga një fletëz pune për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme: Kush mori pjesë? Ku ndodhi? Kur ndodhi? Çfarë ndodhi (çka në fillim, çka pastaj ...)? Si u ndje ai? Pse ishte interesante / emocionuese? Pasi u përgjigjen pyetjeve, nxënësit ndahen në grupe. Çdo nxënës, brenda grupit të tij, tregon atë që u ka ndodhur të tjerëve dhe duhet t'i përfshijë të gjitha përgjigjet e dhëna më parë për pyetjet, duke qenë plotësisht i lirë për të ndryshuar rendin e tyre. Secili grup i zgjedh ngjarjet më interesante / emocionuese dhe të gjithë nxënësit në grup i ndihmojnë nxënësit, ngjarjet e të cilëve janë zgjedhur për t'i shënuar. Një nxënës që nuk ka marrë pjesë në ndodhinë e përzgjedhur e ritregon atë para të gjithëve. Në fund, të gjithë nxënësit i zgjedhin ngjarjet më interesante / më emocionuese dhe i ritregojnë së bashku për të përpiluar një përmbledhje tregimesh nga përvojat e tyre.
- Nxënësve u jepet një tekst interesant dhe frymëzues që është fillimi i ndonjë kallëzimi/rrëfimi. Detyra e tyre është ta vazhdojnë dhe ta zhvillojnë të gjithë kallëzimin/rrëfimin. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili nxënës e lexon kallëzimin/rrëfimin e vet në grup. Secili grup zgjedh kallëzimin/rrëfimin më interesant dhe ai lexohet para gjithë klasës.

- Nxënësve u jepet një tregim i shkurtër. Pasi ta lexojnë, u jepet detyrë të ndryshojnë fundin e tregimit duke e plotësuar me përmbajtje të re ose duke e ndryshuar përmbajtjen në një drejtim tjetër. Ata e shkruajnë ndryshimin që kanë menduar. Disa nxënës e lexojnë përfundimin e ndryshuar dhe shpjegojnë se çfarë arritën me atë ndryshim.
- Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale një tekst sipas një plani që janë marrë vesh më parë për t'iu përmbajtur kompozicionit të një teksti (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi) për temën "*Shoqërimi*". Lexojnë me zë atë që kanë shkruar, kurse nxënësit e tjerë prej tekstit të dëgjuar veçojnë dhe shkruajnë nga një fjali që u ka lënë përshtypje më të madhe.
- Nxënësit zgjedhin dhe lexojnë në mënyrë të pavarur një tekst nga një libër në bibliotekë. Gjatë orës mësimore secili nxënës tregon se cilin tekst e ka lexuar dhe cila pjesë e tekstit i ka pëlqyer më shumë (për shkak të mbresave që i ka lënë, ndjenjave që i ka ngjallur, mendimeve që i ka nxitur, tipareve dhe/ose veprimeve të personazheve). [Kjo veprimtari mund të realizohet në disa orë – nga disa nxënës në secilën orë mësimore.]

Fusha programore: **NJOHURI MEDIATIKE DHE KULTURË E MEDIËS**

Gjithsej: **10 orë**

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë mediet tradicionale dhe digjitale dhe të shpjegojë përparësitë dhe mangësitë e tyre;
2. të dallojë faktet dhe opinionet në përmbajtje mediatike dhe të krijojë përmbajtje mediatike duke përdorur fakte dhe opinione;
3. të përdorë mënyra të thjeshta për të verifikuar informacione dhe fotografi nga interneti.

Nxënësi/sja do të zhvillojë vetëdije për:

4. pasojat nga përdorimi i tepruar i rrjeteve sociale;
5. nevojën për të kontrolluar vërtetësinë e informacionit në internet dhe rrjetet sociale.

Përmbajtjet (dhe konceptet):

- Mediet tradicionale dhe digjitale
- Mediet sociale

Standardet për vlerësim:

- I tregon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet medieve tradicionale dhe digjitale.
- I shpjegon përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të internetit gjatë kërkimit të përmbajtjes.
- I shpjegon përparësitë dhe mangësitë e medieve sociale.

- Fakte dhe mendime/opinionë
(informacion, lajm, intervistë, informacione të pavërteta/dezinformat)

- Bën dallimin ndërmjet përcjelljes së fakteve dhe shprehjes së qëndrimit personal/mendim në përmbajtje mediatike.
- Krijon një lajm të shkurtër për një ngjarje.
- Krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte dhe/ose mendime/opinionë.
- Krijon pyetje të thjeshta për të zhvilluar një intervistë.
- Përdor mënyra të thjeshta për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

- Mësimdhënësi tregon se mediet ndahen në tradicionale dhe digjitale (të reja). Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një fletë pune ku janë të paraqitura medie të ndryshme si televizioni, gazetat, radio, revistat, Snap-chat, Twitter, portalet elektronike, messenger, Facebook, SMS, YouTube, Instagram, Tick-tock, Viber. Detyra e grupeve është të shpërndajnë mediet e përmendura në dy kategori: medie tradicionale dhe digjitale (të reja). Pas prezantimit të punës së grupeve, diskutohet se çfarë është e përbashkët për mediet që grupohen në një kategori dhe çfarë në tjetrën, sipas së cilës dy kategoritë e medieve janë të ndryshme dhe çfarë është e përbashkët për të gjitha mediet. Në fund, përfundohet

se të gjitha mediet janë kanale komunikimi përmes të cilave transmetohen informacionet dhe/ose mesazhet, por ndryshimi është se përmes medieve tradicionale (në formë të shkruar apo elektronike) mesazhet transmetohen në një drejtim, nga një dërgues në disa marrës, ndërsa transmetimi përmes medieve digjitale është shumëdrejtimësh, përkatësisht marrësi i mesazheve mund të reagojë ndaj përmbajtjes dhe tashmë në momentin tjetër mund të jetë edhe krijues edhe dërgues i përmbajtjes.

- Nxënësit shikojnë një dokumentar të shkurtër *Aventurë në shkrim-leximin mediatik* (<https://avmu.mk/%D0%B2%D0%B8%D0%B4%D0%B5%D0%BE-%D0%BC%D0%B0>) % D1% 82% D0% B5% D1% 80% D0% B8% D1% 98% D0% B0% D0% BB% D0% B8-% D0% B7% D0% B0-% D0% BC% D0% B5 % D0% B4% D0% B8% D1% 83% D0% BC% D1% 81% D0% BA% D0% B0-% D0% BF% D0% B8% D1% 81% D0% BC% D0% B5% D0 % BD /). Mësimdhënësi hap një diskutim rreth filmit, me pyetjet e mëposhtme: Çfarë lloj përmbajtjeje mund të gjendet në internet, por edhe çfarë rreziqesh dhe grackash mund të hasni gjatë kërkimit të përmbajtjes në internet? Pas shikimit të filmit, nxënësit, të ndarë në grupe, shkruajnë në letër tri përvojat pozitive dhe tri negative gjatë kërkimit të përmbajtjes në internet. Fletëpalosjet ngjiten në tabelë dhe mësimdhënësi i përdor ato për të hapur një diskutim nga i cili duhet të konkludohet se interneti nga njëra anë, ofron shumë mundësi informacioni, komunikimi, mësimi dhe argëtimi, por nga ana tjetër shumë prej tyre transmetohen nëpërmjet internetit informacione dhe përmbajtje që mund të jenë të pavërteta, të dëmshme dhe të rrezikshme për përdoruesit.
- Mësimdhënësi tregon simbole në rrjete të ndryshme sociale (p.sh. Viber, Facebook, Instagram, Tick-tock, Messenger, Snap-chat) dhe nxënësit identifikojnë rrjetet sociale dhe tregojnë se cilat prej tyre i përdorin dhe për çfarë qëllimi (p.sh. *komunikim, informacion, argëtim, edukim*). Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një fletë pune për krahasimin e komunikimit nëpërmjet rrjeteve sociale me komunikimin e drejtpërdrejtë sipas kriterëve të mëposhtme:
 - *krijimin dhe ruajtjen e kontakteve;*
 - *prezantimin e shkathtësive dhe mundësive të veta;*
 - *shprehja e ndjenjave reale;*
 - *paraqitjen e një imazhi jo të vërtetë për veten;*
 - *qasje ndaj informacioneve;*
 - *vërtetësinë e informacionit;*
 - *qëllime edukative dhe aktivitete.*

Krahasimin e bëjnë ashtu që shkruajnë se cila është përparësia e secilit prej dy llojeve të komunikimit në lidhje me secilin nga kriteret e mësipërme, cila është ai përparësi (p.sh. media sociale ju lejon të krijoni më shumë kontakte dhe të mbani kontakte të përditshme me miqtë në vendndodhje të ndryshme, ndërsa kontaktet që krijohen dhe mbahen përmes komunikimit të drejtpërdrejtë janë më të afërta/direkte). Grupet prezantojnë punën e tyre. Së fundi, përmbledhet se komunikimi përmes medieve sociale ka shumë përparësi, por që nuk mund të zëvendësojë komunikimin e drejtpërdrejtë.
- Nxënësve, të ndarë në dyshe u jepet një fletë pune me dhjetra pohime, për të cilat duhet të theksojnë nëse tregojnë fakte apo mendime, sipas asaj nëse ato mund të vërtetohen si të vërteta apo jo. (Shembull faktesh: *Qenit i duhet ushqim që të mund të jetojë. Liqenet dhe malet ofrojnë mundësi për rekreacion. Akullorja bëhet me shije të ndryshme.;* shembull për mendime/opinione: *Qeni është miku më i mirë i njeriut. Të shkosh në plazh është më argëtuese sesa të ngjitesh në male. Më e shijshme është akullorja me shije çokollate.*). Pas vendosjes së përgjigjeve të sakta,

arrihet në përfundimin se faktet mund të verifikohen dhe vërtetohen se janë të vërteta dhe se ato janë të paanshme (nuk mbështesin një këndvështrim, por e paraqesin informacionin në mënyrë objektive), ndërsa mendimet /opinionet pasqyrojnë pikëpamje dhe bindje për disa gjëra dhe për këtë arsye janë subjektive dhe të njëanshme.

- Mësimdhënësi fillimisht paraqet një lajm gazetaresk në të cilin paraqiten vetëm fakte për një aksident trafiku dhe më pas paraqet një tekst gazetaresk që përmban përgjigjet e më shumë personave që flasin për aksidentin e ndodhur dhe përfundon me mendimin e tij për aksidentin. Nxënësit, të ndarë në grupe, krahasojnë dy tekstet për t'iu përgjigjur pyetjes së mësimdhënësit: Ku paraqiten faktet dhe ku janë opinionet? Grupet ndajnë përgjigjet e tyre dhe së bashku arrihet në përfundimin se në lajmet gazetareske informacioni jepet në formë faktesh/të dhënash dhe në tekstin tjetër shprehen mendime/qëndrime në lidhje me një dukuri apo situatë. Diskutohet për dallimin mes fakteve dhe mendimeve për sa i përket vërtetësisë dhe aftësisë së tyre për t'u verifikuar/konfirmuar, si dhe nëse ato shprehin qëndrimet/bindjet e dikujt apo bazohen në vëzhgim/kërkim. Në fund, grupet e nxënësve përgatisin një prezantim mbi shkaqet e aksidenteve në trafik (për një nga arsyet e mëposhtme për grup: vozitje e shpejtë, kalimi i semaforit në të kuqe, vozitja nën ndikimin e alkoolit) ku deklarojnë faktet të cilat i gjejnë në internet, nga burimet përkatëse dhe japin mendimin e tyre për temën.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, zgjedhin një ngjarje interesante që ka ndodhur në shkollë ose në vendbanimin e tyre. Detyra e tyre është të shkruajnë lajme për ngjarjen duke përdorur fakte - të thonë se çfarë ndodhi, kush mori pjesë, si, ku dhe kur ndodhi. Njëri nga nxënësit në rolin e gazetarit lexon tekstin e shkruar dhe një tjetër e incizon me celular. Incizimet e të gjitha grupeve prezantohen dhe vlerësohen së bashku nëse janë të pranishëm të gjithë elementët e nevojshme për të përshkruar ngjarjen (çfarë?, kush?, ku?, kur? dhe si?).
- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë një tekst mediatik që synon të informojë dhe shpjegojë nxënësve më të vegjël se përse nuk duhen përdorur qeset plastike dhe enët plastike. Detyra e tyre është të përdorin fakte bindëse dhe mendime ekspertësh për rreziqet e përdorimit të objekteve plastike rreth planetit Tokë. Ata mund të kërkojnë informacionin në internet ose nga medie të tjera. Tekstet e shkruara u lexohen nxënësve më të vegjël gjatë mësimin ose bashkohen në një broshurë që u shpërndahet nxënësve më të vegjël.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, përgatisin nga 3 pyetje për intervistë, nëpërmjet së cilës marrin mendimin e psikologut ose të pedagogut të shkollës se si nxënësit mund të zhvillojnë zakone të shëndetshme të jetesës. Grupet lexojnë pyetjet dhe në një diskutim të përbashkët i zgjedhin 5-6 pyetje të cilat do t'i vendosin në intervistë reale. Gjatë intervistës, një nxënës bën pyetjet, një tjetër i shkruan përgjigjet dhe një i tretë i incizon me celular. Intervista publikohet në faqen e internetit të shkollës në formë të shkruar dhe/ose të incizuar.
- Mësimdhënësi përgatit informacion jo të vërtetë me titull *Gorilla arratiset nga kopshti zoologjik* i Nju Jorkut. Në tekst thuhet se kur kafsha arratiset, rritet më shumë rreziku nga gorillat, si dhe paralajmëron njerëzit që të mos dalin nga shtëpia. Nuk përmendet Nju Jorku dhe as burimi i lajmit. Teksti shoqërohet me një foto të një gorilleje që ecën në një rrugë të një qyteti. Lajmin e ndan me nxënësit bashkë me foton. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe u jepet detyrë të kontrollojnë vërtetësinë e lajmit dhe vërtetësinë e fotografisë. Për këtë qëllim, ata kërkojnë në internet – shkruajnë *Gorilla u arratis nga kopshti zoologjik* dhe zbulojnë se nuk ka asnjë njoftim për lajme të tilla nga burime përkatëse. Për të kontrolluar foton përdorin faqen <https://images.google.com/> (sipas udhëzimeve të mësimdhënësit) dhe përfundojnë se fotografia është nga një qytet tjetër. Bashkërisht përfundojnë se lajmi është i rrejshëm, ndërsa fotografia nuk është e besueshme. Nëpërmjet diskutimit nxirret përfundimi se është shumë e lehtë (sidomos me anë të rrjeteve sociale) të postohen informacione të pavërteta dhe të shpërndahen foto të rreme

ose të ndryshuara.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen e secilit nxënës në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënës dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave / përmbajtjeve / koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi i ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënës duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione prapavepruese të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- punimet e nxënësve (krijime, deklarata etj.);
- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- përgjigjet e dhëna në fletëzat e punës;
- realizimet praktike (të lexuarit, të shkruarit);
- detyrat e shtëpisë;

- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies.

Vlerësimi sumativ kryhet në bazë të të dhënave të përgjithshme të përfituara nga përcjellja e arritjeve të nxënësit dhe nga vlerësimi formativ, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, ku mësimdhënësi konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të të arriturave për çdo nxënës veçmas, në kuadër të secilës fushë programore. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti 2022/2023
Institucioni/bartës i programit	Byroja e zhvillimit të arsimit Биро за развој на образованието
Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën V. Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по <i>Албански јазик</i> за V одделение.	nr. 18-17817/8 viti 22.12.2021

